



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_\_\_ .04.2026

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

Objekti i Procedurës: “Shërbim për siguracion automjeteve TPL + kasko”

Kodi Përkatës Në Fjalorin E Përbashkët Të Prokurimit (CPV): 66514110-0 - Shërbime për sigurimin e mjeteve motorrike

Vlera e Fondit Limit 3,939,376 (tre milion e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1. Liçensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me shërbimet objekt i kontratës, leshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF), Aneks 1, (Klasat A/1 dhe 3). Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërise.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe shërben për të garantuar AK se ofertuesi është i licencuar për kryerjen e këtij aktiviteti në bazë të ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Aneks 1 A (klasat 1 dhe 3).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % se vlera e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

### **Si dëshmi për përvorjen e mëparshme kërkohen të paraqiten:**

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

### **OSE**

Ne rastin e përvorjes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Licenca profesionale për të paktën një person ***për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit në sigurime për demet materiale***, lëshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF)

### **Për specialistin vlerësues për demet materiale duhet të paraqiten:**

- Licenca si vlerësues demesh
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit që provon se vlerësuesi i demëve është i punësuar pranë operatorit ekonomik.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e specialistit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë aftësinë teknike dhe kanë staf të specializuar për vlerësimin e dëmeve dhe ky kriter është në përputhje të plotë dhe proporcional lidhur me kontratën objekt prokurimi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **Njesia e prokurimit:**